

# OFERTË

Duke u bazuar ne projektin ideor dhe kushteve të Hartes Zonale për atë pjesë të parcelës, Komunës së Gjakoves ju paraqesim këtë propozim ofertë që përfaqëson një mundësi të shkëlqyer dhe potencial të lartë për tërheqjen e vizitorëve:

Objekti – Parking – Hoteli që planifikohet të ndërtohet sipas kushteve të Hartës Zonale në pronën komunale me sipërfaqe e përafert *Bodrumi:  $9,316 \text{ m}^2 \times 80\% = 7,452.8$  mesatarja e sipërfaqes se bodrumit per 1 parking 299 vendparkingje x 2 bodrume = 598 vendparkingje.*

*Ndërsa pjesa e sipërfaqes totale sipas kushteve të Hartes Zonale planifikohet sipas projektit ideor në sipërfaqe të përafert  $40,514.00 \text{ m}^2$ .*

Me realizimin e këtij projekti, në planifikojmë që të punësojmë një numër të madhë te punëtorëve mbi 1000 punetorë që do te marrin paga nga ky projekt qe do të jetë aktiv.

Vlera e projektit do të jetë sipas paramases 19,736,395.10 € EUR

**Në emër te kompensimit të pjesës së shfrytëzimit të pronës komunale, ne ofrojmë si vijon:**

Komuna do të merr në pronësi në emër të kompensimit totalin e Bodrumit - 2 – me sipërfaqe siç përcaktohet me Harten Zonale **7,452.80 m<sup>2</sup>**, Bodrumi -1 me sipërfaqe **209.80m<sup>2</sup>** Perdhesa Parkingu I autobuseve **779.7 m<sup>2</sup>** sipërfaqja ne total e ofruar eshte **8442.30m<sup>3</sup>** (20.83%) që do të shfrytëzohet si parking për nevojat Komunës së Gjakovës;

Kurse Bodrumi -1, do ti lejohet Komunës së Gjakovës që sipas nevojës të shfrytëzojë në rast kur ka ndeshje në stadiumin e qytetit, me kusht që paraprakisht të njoftoj shfrytëzuesin e parceles.

OFERTUES

N.T.Sh., „Eldaard“



20.05.2024

## Historiku i veprimtarive

1. Bashkëpronar ne qendrën tregtare Galeria Shopping Mall në Prizren.
2. Bashkëinvestitor në qendrën tregtare Art Mall në Mitrovicë.
3. Kemi kontratë shitjeje për produkte të çimentos me prodhuesin Titan Greqi për territorin e Kosovës.
4. Shitje me shumicë të produkteve ndërtimore si Armaturë, Blloka betoni, etj., në territorin e Kosovës.
5. Zhvillim të projekteve ndërtimore banesore në Mitrovicë dhe Prishtinë.
6. Shërbime konsulence për financa dhe kontabilitet.
7. Shitje me shumicë të artikujve të teknikës dhe artikujve të tjerë për shtëpi.
8. Shitje me distribuim në zinxhir të marketeve me artikuj jo ushqimor.

Në RVM kemi si biznes familjar kontratë me Valdrin Sahiti për shitje dhe ndërmjetësim të produkteve të tyre, si dhe me Sellma & Kaci për shërbimet e tyre në lokalin që e kemi të destinuar për këto dy lloj veprimtarie.


Kemi bashkepunime me shum brende te njohura nderkombetare te lemive te ndryshme per territorin e Kosoves.

Po ashtu, kemi në RVM distribuim me artikuj te ndryshem ushqimor.

Për çdo informacion ose detaje shtesë që ju nevojiten, jemi në kontakt.

Me respekt,

Jeton Bakalli





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	02.05.2024
Për:	Jeton Bakalli, përfaqësues i “Jeton Bakalli B.I” - Prishtinë
Kopje:	Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Përgjigje në kërkesë

*Ardian Gjini*

I nderuar z. Bakalli,

Komuna e Gjakovës, përkatësisht Zyra e Kryetarit ka pranuar kërkesën tuaj për negociim për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale në pjesën e parcelës me numër P-70705029-00468, Z.K Gjakovë – qytet, e evidentuar në emër të Komunës së Gjakovës.

Komuna e Gjakovës ka shqyrtuar kërkesën tuaj, lidhur me këtë ju njoftojmë se në parim aprovohet kërkesa për takim, caktohet takimi për paraqitjen e shprehjes së interesit për pronën komunale me datën 07.05.2024, duke filluar nga ora 11:00 h, në zyrën e Kryetarit të Komunës.

Andaj, pala – kërkuesi në këtë takim duhet të paraqesë nëse i posedon dokumentacionet si në vijim: **Projektin për investime, Planin dinamik të realizimit të investimeve, vërtetimin që nuk ka obligime tatimore dhe qarkullimin bankar për vitin paraprak.**

Me respekt!